



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË KULTURËS DHE INOVACIONIT
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
QËNDRA FORMIMIT PROFESIONAL PUBLIK NR.4

Nr. 171 prot

Tiranë me 14.02.2024

Lënda: Njoftim për lëvizje paralele

**DREJTORISË JURIDIKE DHE BURIMEVE NJERËZORE
DREJTORISË SË MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN
AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE**

Në zbatim të ligjit nr. 15/2019, "Për nxitjen e punësimit"; të ligjit nr. 15/2017, "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë"; të vendimit të Këshilli të Ministrave nr. 554, datë 31.7.2019, "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të punësimit dhe aftësive"; të udhëzimit nr. 14, datë 27.05.2021, "Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarinë e ofruesve publikë të arsimit dhe formimit profesional", QFPP Nr.4, ju njofton krijimin e lëvizjes paralele për pozicionin instruktor me kohë të pjesshme :

Instruktor/e për kursin Saldim-----1 Person
Instruktor/e për kursin Kujdestari Fëmijësh-----1 Person
Instruktor/e për kursin Instalime dhe mirëmbajtje hidraulike-----2 Person
Instruktor/e për kursin Termohidraulike-----1 Person
Instruktor/e për kursin Automekanik-----1 Person
Instruktor/e për kursin Berber-----1 Person
Instruktor/e për kursin Kujdestari për të moshuar-----1 Person
Instruktor/e për kursin Hekurpunim-----1 Person
Instruktor/e për kursin Elektroauto-----1 Person
Instruktor/e për kursin Graphic Design-----1 Person
Instruktor/e për kursin Sekretari-----1 Person
Instruktor/e për kursin Instalime dhe mirëmbajtje e rrjetit elektrike-----3 Person
Instruktor/e për kursin Kuzhinë-----2 Person
Instruktor/e për kursin Manikyr dhe Pedikyr-----1 Person
Instruktor/e për kursin Riparim i pajisjeve Audio Televizive-----1 Person
Instruktor/e për kursin Parukeri-----2 Person
Instruktor/e për kursin Rrobaqepsi-----1 Person
Instruktor/e për kursin Web Design-----1 Person
Instruktor/e për kursin Administrator ndërtesash-----1 Person

1. Kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posaçme

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme për lëvizjen paralele si vijon:

- të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
- të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
- të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
- të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit;
- të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe të motivimit.

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e posaçme si vijon:

- a) të ketë diplomë nga një shkollë e mesme profesionale ose kualifikim profesional pas të mesëm, në fushën/profesionin e kursit/kurseve të formimit profesional, për të cilin po aplikon;
- b) të ketë të paktën 3 (tre) vjet përvojë pune në fushën, në të cilën është kualifikuar;
- c) të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit.

2. Dokumentet e aplikimit

Dosja e aplikimit, e cila përmban dokumentacionin e kërkuar, sipas njoftimit të vendit të lirë, duhet të përfshijë:

- a. letërmotivimin për pozicionin;
- b. jetëshkrimin (CV-në);
- c. kartën e identitetit;
- d. diplomën;
- e. librezën e punës;
- f. çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në CV;
- g. certifikatën dhe dëshminë për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;
- h. vërtetimin e gjendjes shëndetësore;
- i. vërtetimin e gjendjes gjyqësore;
- j. vërtetimin nga punëdhënësit i fundit, që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi
- k. të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm.
- l. Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose të noterizuara;
- m. Dokumentet në gjuhë të huaj duhet të jenë të përkthyer dhe të noterizuara.

Dokumentet e aplikimit dorëzohen në protokollin QFPP NR.4 Tirane, brenda datës 21.02.2024

Duke ju falenderuar per mirekuptimin

